

BASHKIA TIRANË
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "STERKAJ" TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 5, Blv. "Bajram Curri", mbrapa pallateve Agimi, Pallati 7/1B, Kati 2, J68310708M & "V.A.S. KONSTRUKSION, Rruga " Andon Zako Çajupi", Qendra Zayed Bussiness Center, seksioni 3 C, D, kati III-të, Tirane, L61322023P.

Procedura e prokurimit: "Ndërtimi shkollës 9- vjeçare Dritas".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-8843-03-01-2021

Fondi limit për objektin “Ndërtimi shkollës 9- vjeçare Dritas”, është 177,714,390 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e katërbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Tender i Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e perzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Udhëzimit Nr. 1, datë 13.02.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 7.1; Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 31 dhe Neni 35/1 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Neni 34 dhe Neni 41.

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “C O L O M B O” J82916489E & “XHENGO” J64103171M & “ERGI” K02727229P.
- Operatori Ekonomik “NDERTIM MONTIMI PATOS” J63229454K
- Operatori Ekonomik “R& T” J61901094G
- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik ”STERKAJ”J68310708M & “V.A.S. KONSTRUKSION” L61322023P

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Colombo shpk & “Xhengo” shpk & “Ergi”shpk.

Oferta ekonomike = 177,712,782 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik “R& T”shpk.

Oferta ekonomike = 177,713,671.57 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ”Sterkaj”shpk & “V.A.S. Konstruksion shpk.

Oferta ekonomike = 174,360,646 (njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

- Nuk ka operatorë të skualifikuar

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve ekonomik ”Sterkaj”shpk & “V.A.S. Konstruksion shpk, se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 100 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Përgjegjës, Bashkia Tiranë*, sigurimin e kontratës prej 15 % të vlerës së saj, siç parashikohet në Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 43, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, konkretisht Bashkimit të Operatorëve ekonomik “Colombo shpk & “Xhengo” shpk & “Ergi”shpk, i vlerësuar me 98.8 pikë.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 23 / 04 / 2021

Ankesa: Në fazën e parë të procedurës së prokurimit nuk ka pasur ankesa.